



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 11/2011

Prishtinë, më 24.05.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostić.

Munguan: Fikrim Damka dhe Visar Ymeri.

Të ftuarit për raportim: Ekrem Hoxha, Kryetari i bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe Lulzim Kurtaj, anëtar i bordit i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZPRK; Fitim Salihu – KDI dhe Lejla Selimi - OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 17.05.2011;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2010;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi- tha se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.05.2011;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.05.2011, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2010;

Kryetari - tha se Komisioni gjatë javës së kaluar ka pasur dy aktivitetet **1.** Komisioni në bashkëpunim me Shërbimin për Hulumtime Parlamentare NDI-n ka organizuar një tryezë diskutimi me temë: Përmirësimi i kornizës ligjore për mjedisin biznesor në Kosovë. **2.** Komisioni ka realizuar një vizitë punë në Ministrin Tregtisë dhe Industrisë. Dhe në bazë të Planit të punës që janë të parapara do të ketë edhe vizitë punë në institucionet e tjera të cilat komisioni i ka për ti mbikëqyre. Në vazhdim, kryetari theksoj se siç është paraparë për këtë pikë të rendit të ditës, ku do të shqyrtohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2010, kemi ftuar kryetarin e Bordit z.Hoxha, i cili do të paraqet një ekspozë të shkurtë për këtë Raport.

Ekrem Hoxha (Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit-ART-së)

– tha që raporti përmbledh dhe paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e telekomunikimeve, si dhe të dhëna thelbësore teknike e komerciale për aktivitetet e rregulluara në sektorin (tregun) e telekomunikimeve në Republikën e Kosovës. Korniza ligjore e përcakton ART-në si institucion përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të telekomunikacionit në Republikën e Kosovës, inkurajimin e sektorit privat që të hyj në tregun e telekomunikacionit promovimin dhe mbështetjen e plotë të konkurrencës së drejtë në përputhje me dispozitat në fuqi rregullimin dhe aplikimin e standardeve unike për të gjithë ofruesit e shërbimeve telekomunikuese zhvillimin e politikave jo-diskriminuese ndaj të gjithë atyre që dëshirojnë të hyjnë në këtë treg si dhe mbrojtjen maksimale të mundshme të konsumatorëve që përdorin shërbimet e ofruara telekomunikuese. Liberalizimi hapja e tregjeve, rregullimi i sektorit tregut të telekomunikacionit përfshi këtu edhe ndalimin e operimit të operatorëve ilegal mobil në Republikën e Kosovës ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e të ardhurave të përgjithshme të operatorëve të licencuar nga shërbimet telekomunikuese, që në total gjatë vitit raportues ka arritë totalin prej mbi 230 milion euro apo rreth 6.7% më shumë se në vitin paraprak. Kjo rritje e përgjithshme e të hyrave ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në rritjen e të hyrave buxhetore të shtetit si dhe ka krijuar kushte të favorshme për investitorët potencial vendor dhe ndërkombëtar. Në anën tjetër, ART-ja brenda mandatit të saj për nxjerrjen e akteve normative, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative për implementimin e ligjit si paraparë me nenin 4 pragrafi 4 të ligjit gjatë vitit 2010 në harmoni me planin e punës ka vazhduar ta komplotojë legjislacionin dytësor përmes hartimit dhe miratimit të rregulloreve dhe akteve administrative të reja si dhe me plotësimin e harmonizimin e atyre ekzistuese. ART-ja respektivisht departamentet e saja, ai i telekomunikacionit i menaxhimit dhe monitorimit të spektrit radio-frekuencor gjatë vitit 2010 kanë filluar së jetësuar dhe ushtruar për herë të parë kompetencën dhe përgjegjësin e monitorimit të tregut operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të licencuar për të konstatuar nëse aktivitetet e tyre kryhen në pajtim me kushtet e licencave dhe autorizimeve të lëshuar me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimeve për

konsumatorët dhe sigurimin e kushteve për një konkurrencë efektive dhe në tregun e telekomunikimeve. Gjatë vitit 2010 ART, për herë të parë e udhëhequr kundrejt një plani të punës dhe planit të veprimit ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes aftësimit të kuadrove në aspektin, profesional, menaxherial e administrativ me qëllim të përmbushjes së detyrave të saja në mënyrë sa më të efektshme, profesionale e transparente. Bordi i ART-së gjatë vitit 2010, ka pasqerësmbëdhjetë (15) mbledhje të rregullta dhe një seri mbledhjesh konsultative kështu duke vendosur për të parë praktikën dhe kulturën institucionale adekuate për institucione të nivelit qendror. Ka siguruar transparencën e kërkuar me ligj dhe konform kësaj praktike vazhdon të takohet në baza të rregullta në mënyrë që të ushtroj dhe t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e saja të përcaktuara me ligjin aktual.

Kryetari – Pyeti për marrëveshjet e bashkëpunimit, a bëhet fjalë për marrëveshje të njëjta me të gjitha shtete dhe cili është interesi kryesor i institucionit të juaj? Gjobat, a kanë ndikuar dhe a keni parë efektin pozitiv të këto kompani në të cilat keni shqiptuar gjoba? A ka gjasa të eliminimit të plotë të operatorëve ilegal dhe çfarë është duke u ndërmarre nga ART-ja? A ka mbështetje të mjaftueshme, cilat janë pengesat më serioze, a kemi shpresë që po bëjmë progres përfundimtar në këtë drejtim? Te renditja sfidave, dhe plani i punës a keni hartuar në përputhje me tregun ndërkombëtar dhe evropian? Te sfidat normative, të ligji, a mundeni ju me kapacitetet e juaja me sponsorizua ndryshimet e nevojshme? Te sfidat kompetencave, ju e çekët edhe në raport të progresit, si sfida cilat janë ato problemet e kompetencave edhe çka ne mundemi të bëjmë më shpjete që ti ndryshojmë në frymën e standardeve evropiane? Për çështjen garancionit bankar në cilën fazë gjenden? Si dhe pyeti për kodin telefonik edhe të kryedomenit shtetëror të internetit?

Teuta Sahatqia – Pyeti lidhur me menaxhimin e frekuencave, a e keni menaxhimin komplet të frekuencave, në qoftë se jo çka nevojitet të merret komplet me autoritetin e ART-së? Sa i përket frekuencave e di që ato janë me pagesë dhe me siguri janë me kohëzgjatje pra në çfarë kohëzgjatje merren licencat, kush mund të marrë licenca, si janë ato pagesa të shpërndara për licenca të ndryshme? Për pajisjet në kontrollin e spektrit a janë pajisjet mobile? U çek që ekziston një problem me stacionin fiks të menaxhimit të mbikëqyrjes së spektrit frekuencor? Sa operatorët kryesor duhet ta kenë një garancion për dëmet e shkaktuara? Për VOICE-Poëer IP a bëhet kërkesa për licencim apo shkon me licenca të internetit? A është njëra prej arsyeve të rënies të telefonisë mobile? A kanë kërkuar licencim operatorët nga Serbia që të funksionojnë në mënyrë legale? Për operatorët e telefonisë mobile ekzistojnë dy operatorë të telefonisë mobile por spektri frekuencor a e lejon licencimin e operatorit të tretë? Cilat janë kushtet e G2-shit dhe a ka pas kërkesë për kalim në G3 apo G4 edhe a varet ajo prej jush apo varet prej kërkesave të operatorëve mobil apo duhet edhe infrastruktura tjetër ligjore që të mbështet kjo kërkesë?

Myzejene Selmani – tha se kisha mu ndalur vetëm në dy çështje në çështjen e plotësimit ndryshim të ligjit për Telekomunikacionin, edhe në mandatin e kaluar kemi pasur bukur shumë edhe diskutime publike edhe me ju, mirëpo shpresoj se në këtë legjislacion do të vjen plotësim ndryshimi i këtij ligji dhe ne do të mundohemi të bëjmë më të mirën e mundshme. Por shpresoj që edhe Ministria e Infrastrukturës do të jetë në bashkëpunim me juve për çdo gjë që mundeni ta japin kontributin në atë plotësim ndryshim të ligjit sepse duhet të ndryshoj, sfidat specifike që i keni çekur në raport çështja e garancionit bankar e potencoi edhe kryetari edhe në mandatin e kaluar ne kemi pasqerë prej jush. Mirëpo tani do të jetë përgjigjja e juaj, çështja e operatorëve ilegal a pritet që ART-ja në një periudhë të shkurt ndoshta të licencoi një operator i cili do të paguaj taksa edhe juve edhe njëkohësisht të hyrat e tyre të hynë në buxhetin e Kosovës? Çështja e brezave frekuencorë u potencua edhe nga znj,Teuta, edhe nga kryetari edhe çështja e kodit kisha pasur një pyetje direkte tani për ju pasi që janë duke u diskutua çështjet e Kosovës-Serbi, bisedime teknike edhe në ato bisedime është edhe çështja e Telekomunikacionit ju si rregullator cilat janë informatat e juaja lidhur me këto bisedime? Ku ne e dimë se akoma ne e zbatojmë

kodin e telefonisë nga Serbia. Çështja e liberalizimit të tregut ne e kemi një vendim nga mandati i kaluar i Qeverisë i cili nuk lejon tjetër operator, cilat janë pengesat e ligjit të telekomunikacionit? Gjatë punës së juaj si rregullator më i pavarur me të cilin përballeni me shumë probleme, çështja e domenit të internetit ju patet potencuar se jeni në disa takimebisedime lidhur me këto çështje.

Hashim Deshishku – pyeti lidhur me çështjen e garancionit bankar i cili është lëshuar në vitin 2006, është një garacion i cili u lëshua nga një Institucion i cili thuhet se nuk ka ekzistua dhe se a ka qenë ai institucion bankar apo vetëm institucion financiar? A është verifikuar në vitin 2006-të ai garacion bankar? Dhe prej cilit institucion ka ardh? Dhe nëse është vërtetuar se ai institucion nuk ekziston atëherë çka ka ndërmarr ART-ja lidhur me këtë? Për operatorët ilegal, ne e dimë që i keni marrë disa aksione për shkyçjen e antenave, por ne ende kemi prezencë të operatorëve ilegal, kur do të eliminohen ato antena që veprojnë ilegalisht? Për dërgesat postare, a është e rregulluar që letrat të vin drejt në PTK, pa u hapur diku tjetër? Sepse ne kemi marrë dërgesa p.sh nga Sllovenia, të hapura nga Serbia. Pyeti sa është e drejtë që VALA e ka edhe Z-mobile edhe 044-045, e IPKO –ja e ka 049 dhe 043 që shfrytëzojnë të njëjtin rrjet? Ne fund tha që raportit është dashur ti bashkëngjitet edhe raporti i auditimit.

Lutfi Zharku – pyeti për akumulimin e detyrimeve nga ana e operatorëve? Nëse i lëshoni frekuencat nëse dikush nuk paguan a i ndalet? a i merret autorizimi i licencave? Çështja e licencës së PTK-së, a është çështje e teknologjisë e cila nuk e ka PTK-ja, apo është çështje e mos vullnetit të PTK-së për me kaluar në një teknologji më të lartë, apo cilat janë arsytet? Kalimi në teknologjinë 3G kur parashihet të ne që duhet të jetë? Disa sqarime më detaje për Konet-in, çka punon? Po ashtu edhe disa sqarime lidhur me vendimet në Qeverisë, për mos dhënie të operatorit të tretë për 5 vite?

Berat Buzhala – pyeti a ka studim të tregut dhe cila është strategjia e zhvillimit nga ART-ja? Për kompetencat e juaja çka keni në plan, si me e zhvilluar edhe më tutje tregun? Kur e dimë se viset rurale janë në gjendje të mjerueshme me qasjen në internet. Si mundet me u zhvilluar edhe më tutje konkurrenca ku në fakt këtu nuk i kemi tre operatorë të licencuar por kemi një që është Dardafoni. I cili në atë drejtim ka edhe hetime zyrtare nga policia me një kontratë krejtësisht të pa favorshme të PTK-së. Kërkojë përgjigje se a është duke shkaktuar dëme Dardafoni, VALA-s në procesin e privatizimit?

Sala Berisha Shala – pyeti për obligimet e institucioneve që kanë ndaj ART-së? Pse është bërë ndryshimi në emërtimin e emërimit nga kryesues në kryetar? Ndoshta kishte me qenë mirë që të ja bashkagjiteni këtijë raporti arsyetimin pse ka ndodh ky ndryshim.

Ekrem Hoxha (Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit-ART-së) - u përgjigj ne pyetje të deputetëve, lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit cili është interesi dhe dallueshmëria e atyre, interesi pikë së pari ka të bëjë me nivelimin e ndërkombëtarizimit, pra Kosova nuk ka pasur asnjë marrëveshje teknike më asnjë nga operatorët e regjionit interesi i dytë është se bëhet shkëmbimi i përvojave dhe i standardeve që i aplikojnë rregullatorët, të gjithë rregullatorët bazën ligjore e kanë në Bashkimin Evropian edhe me rregullatorin Britanisë edhe të gjitha ato merren si baza kryesore por ai elementi dallues qëndron në adaptimin e atyre konform specifikave të Qeverisë. Interesi i shkëmbimeve të përvojave është shumë i madhe dhe ne kemi arritur marrëveshje me Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Turqinë dhe Kroacinë pra secili shtet i ka karakteristikat e veta. Gjjobat dhe efekti i tyre: kapacitetet e kufizuara rreth mandatit paraprak të bordit e ka kufizuar ART-në vetëm në një funksion i cili vetëm shqyrton kërkesa licencon, rregullatori ka shumë më tepër kompetenca në rregullimin e mbikëqyrjes në monitorim të këtij sektori dhe në inkurajimin e investimeve dhe sjelljen e investimeve të huaja, edhe jo shpesh herë kërkesat e ART-së janë pajtuar me kërkesa mandatorë se i përcakton ligji, dhe

natyrisht ligji parasheh për mos respektim të dispozitave gjrobat, ndikimin e gjobave pra kjo i ka vetëdijesuar më shumë operatorët por ka ende punë për tu bërë por efektin ne e gjejmë se është arrit, dhe këtë vit kemi filluar me aplikimin e gjobave edhe do vazhdohet edhe në të ardhmen për aq sa ka nevojë pra efekti i tyre është domethënës. Operatorët ilegal: shumë pyetje rreth kësaj, i kemi realizuar gjatë vitit 2010 dy faza të ndara njëra nga tjetra dhe njëra nga shtatori në ato faza janë konfiskuar 47 stacione bazë njësi komentues bazë ku bëhet transmetimi dhe përpunimi i të dhënave të gjitha ato stacione bazë janë sekuestruar nuk është bërë prerja apo diçka periferike por janë sekuestruar pajisjet boshtore, stacioni bazë, transmetuese e të gjitha ato, janë sekuestruar tri stacione transmetuese mikro valore edhe 125 antena satelitore edhe 98 linçe me pajisjet përcjellëse pra është eliminua infrastruktura boshtore. Kjo ka krijuar një realitet të ri në qoftë se shikohen pasqyrat teknike të operatorëve se sa interferenca kanale janë që ata i paguajnë shtetit se ne kur e japim licencën obligohemi ligjërisht që operatorit të licencuar të i garantojmë shfrytëzim pa interferenca pra është një detyrim i dalur ligjor del karshi shtetit, kjo në bazë të verifikimit të stafit tonë përgjegjës del që në brendi të shtetit tonë duke e përjashtuar veriun janë eliminuar të gjitha interferencat. Çështja e veriut është çështje e sigurisë publike sa i takon ART-së dhe ushtrimit të mandatit të saj ku ART-ja edhe publikisht edhe në komunikime zyrtare me institucionet relevante. ART-ja ka informacione të sakta se çfarë infrastrukture gjendet në veri dhe ajo infrastrukturë përveç që plotëson parakushtet publike dhe parakushtet tani në proces të dialogut mund të rregullohet me një periudhë shumë të afërt kohore por jo pa u krijuar këto parakushtet të cilat e kanë penguar realizimin deri më tani. Sfidat dhe ligji: duhet theksuar se Qeveria e ka kapacitetin dhe mandatin pra është sponsor i ligjit, ata janë sponzoruesit të ligjit edhe ART-ja e ka për detyrim për aq sa i kërkon. Pra ne ART-ja do ta jap kontributin dhe sigurisht se do të ketë nevojë se është një lajmë i mirë që edhe Ministria përkatëse ka marrë konfirmimin nga Komisionin Evropian dhe kjo është një siguri e rritur edhe për Kuvendin edhe për ART-në se do adaptohen principet dhe parimet e bashkimit evropian për rregullatorët nacional. Ne jemi institucion i themeluar nga Kuvendi ligji në fuqi përcakton pasqyrën financiare për shkak të një sistemi shtetëror të konsoliduar nga Ministria e Financave ligji thotë se ART-ja menaxhon të hyra brenda vitit fiskal kundrejt një plani vjetor të punës. Edhe ligji nënkupton se të hyrat do të menaxhohen në proporcion me nevojën për operacion dhe rikthim të një pjese të hyrave të grumbulluara në sektor përmes projekteve kapitale, pra ne kemi obligim të krijojmë kushte për qytetarët për shërbime më universale më të qëndrueshme me kualitet më të lartë duke bërë investime të cilët operatorët i bëjnë me kosto shumë më të lartë dhe atë kosto ja faturojnë të gjithë qytetarëve. Kuvendi e ka rolin përcaktues përmes Komisionit për Buxhet dhe Financa ku në ligj shkruan në mënyrë taksative, ART-ja paraqet projekt buxhetin. Ministria e Financave nuk mund ta ndryshoj atë dhe mund të paraqes në Komision pse ka drejtë në ato pika, por ne ballafaqohemi me një realitet tjetër ne shqyrtojmë propozimin e Qeverisë dhe ART-ja shkon vetëm figurativisht pra ky është një realitet për mua pak i pakuptimet por është i tillë tani. Çështja e kodit: kuptohet këto të gjitha kanë varura nga elementi politik ITO-ja është mekanizëm politik dhe e ka mekanizmin e dy të tretave të shumicë për pranimin e anëtarëve të ri ART-ja aq sa i takon si vartës ndaj detyrimeve të cilat dalin nga ligji ka bërë mjaftë në këtë drejtim, ne kemi pasur një progres domethënës në avancimin drejtë marrjes së domenit shtetëror të internetit dhe këtë vit e kemi angazhuar një ekspert edhe ka punë primare të vetme dhe është menaxher për krye-domenin e shtetit dhe kodit dhe jemi duke i përgatitur të gjitha dokumentacionet e nevojshme për aplikime. Me këtë jemi duke shqyrtuar edhe alternativat se ka edhe alternativa përveç kodeve shtetërore ka kode gjeografike ka kode të ndryshme dhe në një debat me vendimmarrësit me politikë në qoftë se e marrim se çështja e kodit do të jetë e largët ndoshta ekziston mundësia të shkojmë për zgjidhje alternative por është çështje në trajtim e sipër, për krye-domenin janë krijuar disa parakushte për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore dhe besojmë se së shpejti do e paraqesim aplikacionin formal. Kodi është pjesë edhe e dialogut është një spektër i gjerë i debatit në dialog mund të ndodh që ne jemi duke e dhënë kontributin tonë në atë proces, dhe si proces i zhvillimeve të përgjithshme mund të ndodh një zhbllokim. Kohëzgjatja e licencave: është një përgjegjësi e ART-

së për me e hartuar tabelën nacionale të alokimeve ku përfshihet i gjithë spektri, civil dhe ushtarak ne me sesionet e shtuara me angazhim të gjatë mbi gjashtë muaj kemi arrit të harmonizojmë përdorimin e brezit nga KFOR-i dhe tabela e cila ju është dërguar Kuvendit për aprovim i adreson të gjitha kërkesat nevojat e pritura të KFOR-it dhe nevojat e pritura nga FSK-ja por janë të koduara në gjuhën profesionale, për profesionalistët të asaj fushe por është tabela e cila është e përpiluar në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian edhe rregulloret e ITU-së. Kohëzgjatja e licencave, në gjatë vitit 2010 kemi aprovuar një rregullore e cila në funksion të eliminimit të barrierave dhe të krijimit operatorëve shfrytëzues kemi thjeshtësua procedurat e aplikimit individual. Për kohëzgjatjen e licencave njëri nga barrierat më të mëdha e kemi eliminuar, përdorimi disa mujor që përpara ka qenë bllok një vjet tash kemi mundësuar licencimin gjashtë mujor, licencimin një vjeçar, dy vjeçar dhe katër vjeçar. Kërkimi licencave nga operatorët ilegal: formalisht asnjëherë as gjatë kohës së UNMIK-ut, as gjatë kohës sonë formalisht nuk ka, ka vetëm thashetheme por ne nuk kemi parë asnjëherë që kanë aplikua. Ne i kemi njoftuar operatorit serbë dhe ju kemi jap aftë 30 ditë që gjatë atyre 30 ditëve në baza të vullnetit të mirë mund ti lejojmë një periudhë të dokumentojnë nëse kanë ndonjë pritje ilegale nga procesi, por ne nuk kemi pranuar asnjë përgjigje në atë drejtim kështu që nuk ka pasur asnjë verifikim apo aplikim formal. Për licencim të një operatori të tretë: në qoftë se operatorët IPKO dhe VALA e kanë të drejtën të parashtronin kërkesë për resurse frekuencore për përdorim atëherë ART-ja obligohet ligjërisht për me organizua aksion, organizimi i aksionit në paralele me procesin e privatizimit shkakton një dualizëm dhe një konfuzion, dhe për këtë arsye ART-ja nuk shfaq urgjencë në trajtimin e kësaj teme dhe nuk mund akomodohet me kërkesa individuale, pra në ligj përcaktohet si jepen spektri frekuencor ku e ka një relacion në mes të proceseve. Koneti është i licencuar me disa licenca, është operatori i telefonisë mobile edhe fikse dhe ju e shihni se në raport nuk ka ndonjë konkurrencë efektive në sektorin e telefonisë fikse pasi që edhe IPKO nuk ka zhvilluar ndonjë infrastrukturë mirëfillte për të. Respektimi i ligjit: të kuptohemi se ART-ja dhe udhëheqësit e saj natyrisht që janë përgjegjës para ligjit ne nuk jemi pajtuar me interpretimin e predispozitave të ligjit dhe në procedurat e konfliktit administrativ duke argumentuar në çdo procedurë gjyqësore kemi bërë padi ndaj Autoritetit Shqyrtues të Prokurimit - OSHP-së, pran Gjykatës Supreme. Strategjia për studim dhe analizë: natyrisht të gjitha këto të dhëna është përmbushje e detyrimit të ART-së në çdo publikim tonin kemi raporte për portal ku janë të gjitha informacionin për tregun dhe si merren vendim- marrjet kualitative dhe gjithmonë konsulta shtesë mund të adresoheni në ART. ART-ja ka filluar këtë vit për herë të parë analizën e tregjeve të telekomunikimeve edhe aktualisht jemi në analizën e parë që ka fillua në muajin shkurt për sektorin e telefonisë fikse dhe rezultatet nga ai studim do të dalin diku ka shtatori dhe kur të themi analiza i ka efektet për përcaktimin e operatorëve në shtator fillon tregu mobil pason me tregun e internetit dhe brenda 18 muajve planin e punës e kemi me përmbyll me analizat e tregjeve dhe tek atëherë krijohet parakushti i çdo çështjeje në çdo kontekst.

Lulzim Kurtaj (Anëtarë i Bordit i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit-ART) -

Tha se për çështja e garancionit bankar këtu kanë qenë dy komponentë të cilat janë zbatuar në atë kohë komisioni për vlerësim ka qenë miks, vendor dhe ndërkombëtar, dy përfaqësues kanë qenë të UNMIK-ut. Përfaqësuesi i cili ka pasur kompetencën financiare pra komisionin për vlerësim ka qenë i UNMIK-ut. A është garancioni valid, pra ky është rrafshi i parë që është bërë verifikimi, hapi tjetër i verifikimit ka qenë këto të gjitha informacionet për interesat bankare janë dërguar inteligjencës financiare të UNMIK-ut, në atë kohë, në një afat një javor. Pasi që është bërë vlerësimi dhe si e tillë inteligjenca financiare nuk i ka kthyer ART-së, dhe unë sa kam informacione as Qeverisë nuk ju është ndonjë informacion lidhur me jo-validitetin, besueshmërinë apo qëndrueshmërinë e garancionit. Pasi që kjo ka qenë instanca më e madhe për vlerësimin dhe pasi që Qeveria nuk ka pranuar ndonjë informatë kthyesë prej saj. Atëherë është vlerësuar se çdo gjë është në rregull, pra kjo pyetje është trajtuar edhe prej UNMIK –ut faktikisht edhe EULEX-it i është thënë që për informacionet në këtë drejtim faktikisht është informuar me dokumentacion të plotë se kopje të saj sepse të gjitha këto që i përmenda nuk kanë marrë

informacion kthese. Tema edhe për VOICE-IP ne nuk jemi licenca specifike për VOICE-IP pasi që ne e kemi atë parimin e neutralitetit në përgjithësi. Pra janë dy komponentë të cilat në një mënyrë ose tjetrën e kufizojnë mundësinë e asaj VOICE-IP për me ofruar shërbime telekomunikuese publike por si e tillë në njëfarë mënyre nuk diskriminohet është e mundur të përdoret si teknologji duke e përmbushur mundësinë e shërbimit emergjent dhe të gjitha shërbimeve që dalin nga aktet nënligjore.

Pas debatit të gjerë Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit ART -së, për vitin 2010.

dhe Kuvendit i parashtron këtë:

Rekomandim

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit ART -së , për vitin 2010.*
- 2. Arsytimin e Raportit me rekomandime e paraqet, kryetari i Komisionit Zenun Pajaziti.*

4. Të ndryshme

a) Autoritetit i Konkurrencës së Kosovës AKK

Kryetari - i njoftoi anëtarët e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës AKK –së i kanë sjelle përgjigjet shtesë më shkrim për pyetjet e deputeteve dhe Komisioni autorizoj Njësine mbështetëse që të procedoj për seance plenare Rekomandimin e Komisionit.

b) Mbledhje e radhës e Komisionit

Kryetari – i njoftoi anëtarët e Komisionit se nesër mbahet mbledhja e radhës në ora 11:00 pika rendit të ditës do të jetë Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente të Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit